



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.346/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi Kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 06.02.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa Anr.346/2025 datë 03.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë A.nr.346/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën pretendon se me datë 3 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë ka identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të kandidatëve për deputet të LDKsë, Lumir Abdixhiku, Vlora Dumoshi, Florian Dushi, në rrugën "Tirana", në Komuna Prishtinë.

Sipas parashtruesit të ankesës baneret/posteret janë vendosur pa leje të organeve kompetente, në hapësirat e jashtme të ndërtesës kolektive- publike.

Me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik LDK kanë bërë Shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë, dhe kërkojnë nga PZAP-i, që duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lart cekura, që masa e sanksionit të vendoset sipas legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), thekson se pretendimet e Lëvizjes Vetëvendosje në ankesën Pretendimi se kandidatet per deputet Lumir Abdixhiku, Vlora Dumoshi, Florian Dushi me rastin e vendosjes se posterieve ne IT."Tirana" kane shkelur nenin 34 paragrafi 1 , nen paragrafi 1.2 te Ligjit per Zgjedhjet e Përgjithshme nuk qëndron, ngase te njëjtë e kanë Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike — Komuna e Prishtinës. Pëlqimi në fjalë është marrë me inicimin e kërkesës nga kandidati Florian Dushi për leje vendosë për 4 postera, dhe per 4 kandidat. Duke marrë parasysh ato që u ceken me lartë kërkojmë nga PZAP që të marr vendim meritor për rastin në fjalë, dhe duke u bazuar në krejt ato që u thanë kërkojmë që ankesat e subjektit LVV të refuzohet si e pabazuar.Përgjigjes në ankese i ka bashkangjitur Pëlqimin 07-353/02-12942/25, datë 24.01.2025.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj, dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme, dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës reklamuese per vendosjen e 4 posterave per 4 kandidat ne rrugën Tirana te lëshuar nga Drejtoria per Shërbime Publike me numër 07-353/02-1294/25 te datës 24.01.2025.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.346/2025 më datën 06.02.2025

Kryesuesi i Panelit,
Bujar Muzaqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.